



# ARGUMENTUM

news opinion analysis



Edicion special

# DISA REFLEKTIME RRETH KINËS



Special edition

**Some  
Observations  
on China**

*“Kina është e përkushtuar të ndërtojë një botë paqeje të qëndrueshme përmes dialogut dhe konsultimit, një botë të sigurisë universale përmes bashkëpunimit dhe përfitimeve të përbashkëta, një botë të prosperitetit të përbashkët përmes bashkëpunimit reciprokisht të dobishëm, një botë të hapur dhe gjithëpërfshirëse përmes shkëmbimeve dhe mësimi të ndërsjellë, një botë të pastër e një botë të bukur përmes zhvillimit të gjelbër dhe me karbon të ulët.”*

Xi Jinping - Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Komuniste të Kinës (PKK) dhe President i Republikës Popullore të Kinës (RPK) Kongresi 20-të Kombëtar i PKK-së, tetor 2022

*“China is committed to building a world of lasting peace through dialogue and consultation, a world of universal security through collaboration and shared benefits, a world of common prosperity through mutually beneficial cooperation, an open and inclusive world through exchanges and mutual learning, and a clean and beautiful world through green and low-carbon development.”*

Xi Jinping - General Secretary of the Communist Party of China (CPC) and President of the People's Republic of China (PRC). 20th National Congress of the CPC, October 2022

*Ky edicion special në Argumentum.al ka në fokus Republikën Popullore të Kinës (RPK) në aspektin gjeopolitik, mediatik, ekonomik, diplomatik e më tej. Duke mbledhur zëra të tre analistëve shqiptarë, është d'ashur të jepet një perspektivë lokale mbi marrëdhëniet dypalëshe, shumëpalëshe, potencialet e bashkëpunimit, sfidat, dhe narrativën.*

*This special edition of Argumentum.al focuses on the People's Republic of China (PRC) in terms of geopolitics, media, economics, diplomacy, and beyond. By gathering the voices of three Albanian analysts, it aimed to provide a local perspective on bilateral and multilateral relations, cooperation potentials, challenges, and the narrative.*

© 2023 Argumentum & Albanian Institute for Globalization Studies (AIGS)

## Përmbajtja

“Një brez, një rrugë”, Kinë-EQL dhe pozicionimi i Shqipërisë mes nismave kineze 03

Dinamikat Globale, Perspektiva Kineze 07



Dr. Marsela MUSABELLIU

28 Belt and Road Initiative, China-CEEC, and Albania's positioning in Chinese initiatives

32 Global Dynamics, Chinese Perspective

Pikë madhore reference gjeopolitike për Kinën! 11

“Gjynahet” kineze dhe “mëkatet” perëndimore! 14



Dr. Jorgji KOTE

35 A major geopolitical reference point for China!

38 Chinese "faults" and Western "sins"!

Kina në Ballkanin Perëndimor, mite dhe realitete 19

Portretizimi i Kinës në median shqiptare 24



Marjana DODA

41 China in the Western Balkans: myths and realities

45 China's portrayal in the Albanian media

# “NJË BREZ NJË RRUGË”

## Kinë-EQL dhe pozicionimi i Shqipërisë mes nismave kineze



Dr. Marsela MUSABELLIU

**N**evoja e një vendi të vogël për të qenë nën huret e një fuqie të madhe është justifikuar nga studiuesit kryesisht në aspektin e të ashtuquajturës “*Dilema e Liliputëve*”. Teoria e hedhur në botën akademike nga Robert

Keohane që në vitin 1969, argumenton se një fuqi e madhe mund t’i sigurojë një shteti të vogël shumë më tepër sesa aksesin ose të drejtën për t’u konsultuar. Në fjalët e Keohane, vendi i vogël mund të rrisë ndikimin thelbësor duke zgjeruar dhe thelluar lidhjet që kontribuojnë në levën politike të fuqisë së vogël duke parë në radhe të parë interesat e veta kombëtare.

Për sa i përket marrëdhënieve me “të fuqishmit”, shqiptarët janë të vetëdijshëm se disa nga vendimet më të mira dhe disa nga më të këqijat që janë marrë ndonjëherë për të vulosur fatin e kombit, janë marrë nga Fuqitë e Mëdha. Pra, shpeshherë duket

se është bërë normale që në kulturën popullore kjo mirënjohje kufizon servilizmin, kurse antagonizmi kufizon fanatizmin. Qoftë kjo për interesa politike apo dogmatizëm doktrinar, miratimi apo mosmiratimi i thellë për një pushtet të caktuar nuk është kurrë në interesin e një kombi të vogël. Shtetet e vegjël duhet të shmangin futjen në kurth nga polarizimi i panevojshëm, i parakohshëm dhe vetë-përmbushës, shprehet Keohane.

“Të fuqishmit” në shekullin e 21-të janë shumë, por polarizimi në Shqipëri është i njëanshëm. Në mënyrë gati të pashpjegueshme, rëndësia aktuale

ekonomike dhe politike kineze në skenën botërore nuk perceptohet apo portretizohet siç duhet në Shqipëri, pra veprimet dhe reagimet e institucioneve politike shqiptare (të mëparshme dhe të tanishme) duken në mëdyshje kur kemi të bëjmë me Republikën Popullore të Kinës në tërësi, ose në lidhje me nismat kineze në veçanti. Në një nivel perceptues, konstatohet se përfshirja e Kinës në Shqipëri dhe rajon është marrë si një paradigmë kërcënim-mundësi ose konkurrencë-bashkëpunim dhe në disa raste, zërat alarmues gjejnë baza të forta lokale për të mbështetur teoritë e tyre. Diskursi publik është jashtëzakonisht i polarizuar në lidhje me Kinën, në të gjithë rajonin, jo vetëm në Shqipëri, por Shqipëria ka disa karakteristika specifike.

### **Nisma “Një brez, një rrugë” dhe Shqipëria**

E shpallur nga Presidenti i Kinës Xi Jinping në vitin 2013, si një strategji e zhvilluar nga qeveria kineze, nisma “Një brez, një rrugë” u mbështet tek ajo që ishte një produkt ikonik i Kinës, dhe ndër shekuj u bë pjesë e historisë tregtare dhe kulturore botërore, Rrugë e Mëndafshit. Nisma “Një brez, një rrugë”

(BRI) po përpiqet të rigjurmtojë rrugët e lashta tregtare të Rrugës së Mëndafshit duke lidhur Lindjen dhe Perëndimin në rrugë tokësore dhe rrugë detare. Sipas pasqyrit të nismës nga Komisioni Kombëtar i Zhvillimit dhe Reformës të Kinës, BRI bazohet në pesë prioritete bashkëpunimi: Koordinimi i politikave: Lehtësimi i ndërlidhjes: Tregtia e lirë ose e papenguar: Integrimi financiar: Lidhjet dhe shkëmbimet mes njerëzve. Sikurse vetë nisma, prioritetet janë në evolucion të vazhdueshëm. Mbështetja e kësaj nisme në rang botëror është e jashtëzakonshme në më shumë se  $\frac{3}{4}$  e vendeve anëtare të OKB, dhe për të qëndruar në kontinentin tonë, 18 vende të Bashkimit Evropian janë pjesë e saj.

Autoritetet kineze e shohin infrastrukturën si mjetin më të mirë për të arritur të ashtuquajturat “Korridore Ekonomike”. Por, korridoret ekonomike kërkojnë mbështetje financiare dhe sipas kalkulimeve të fundit në bazë të projekteve të nisura, nëse BRI-ja do të ishte një shtet, do të renditej si ekonomia e tetë më e madhe në botë, duke eklipsuar Italinë, Brazilin, Kanadanë dhe Rusinë. Planet e BRI-së janë

**”  
Autoritetet kineze e shohin infrastrukturën si mjetin më të mirë për të arritur të ashtuquajturat “Korridore Ekonomike”. Por, korridoret ekonomike kërkojnë mbështetje financiare dhe sipas kalkulimeve të fundit në bazë të projekteve të nisura, nëse BRI-ja do të ishte një shtet, do të renditej si ekonomia e tetë më e madhe në botë, duke eklipsuar Italinë, Brazilin, Kanadanë dhe Rusinë. Planet e BRI-së janë projekte tejet ambicioze, por për Kinën kjo nuk është gjë e re.**

projekte tejet ambicioze, por për Kinën kjo nuk është gjë e re. Për shumë shekuj me radhë Kina nuk kishte konkurrencë për sa i përket efikasitetit, kompetencës ose aftësisë së saj për të ndërmarrë projekte të mëdha në shkallë të gjerë. Kjo nismë mund të përfaqësojë një model tjetër gjithëpërfshirës për bashkëpunimin ekonomik dhe politik ndërkombëtar dhe ndoshta iniciativën më ambicioze të politikës ndërkombëtare kineze në histori. Por nuk është gjithçka infrastrukturë, Kina e ka promovuar BRI-në si një mjet për paqen, stabilitetin dhe prosperitetin. Qëllimi i BRI-së është ai i integritit ekonomik dhe potenciali i jashtëzakonshëm i një epoke të re të prosperitetit global. Shqipëria bëhet zyrtarisht





pjesë e BRI në vitin 2017: Samiti i Parë i BRI i mbajtur në Pekin në 2017-ën shënoi edhe pjesëmarrjen zyrtare të Shqipërisë në këtë nismë. Me këtë rast ishte i pranishëm ministri i Transportit dhe Infrastrukturës Sokol Dervishaj, i cili nënshkroi Memorandumin e Mirëkuptimit (MoU) me He Lifeng, Ministër Përgjegjës për Komisionin Kombëtar të Zhvillimit dhe Reformës. Memorandumi me shtatë pika u fokusua në forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në fushat e transportit, infrastrukturës dhe financave.

Çfarë ka ndodhur që nga ai vit deri sot? – Praktikisht rruga është e hapur nga pala kineze, por kjo rrugë nuk është shkelur ende nga pala shqiptare. Implikacione politike që janë shpesh i vetmi përshkrim i BRI kanë triumfuar mbi pragmatizmin në bashkëpunim. Asnjëherë në historinë moderne, një nismë kineze nuk ka marrë kaq shumë kundërshti politike, mediatike dhe analitike sa ka marrë nisma “Një brez,

një rrugë”. Në fakt para së në Evropë të vinte nisma, erdhën zërat kundërshtarë me fjalë si influencë, potencial ndërhyrës, mund të impaktojë politikat e brendshme, dhe më e (keq) përdorura “kurthi i borxheve”... Ja ku jemi një dekadë më vonë, dhe asnjë nga këto nuk është vërtetuar ose materializuar, dhe shumica e vendeve të BE-së e kanë përqaftuar nismën.

#### **Platforma Kinë-EQL, Shqipëria pjesë që në krijim të saj (2012)**

Shqipëria është një nga vendet bashkëfirmëtare të krijimit të platformës Kinë-EQL në vitin 2012 në Poloni. Atje ishte zv. Kryeministri i kohës Edmond Haxhinasto që firmosi me Kryeministrin e atëhershëm kinez Wen Jiabao. Që në fillimet e kësaj platforme, pritshmëritë në Shqipëri ishin të larta, por edhe ndoshta disi të keqinterpretuara. Në fillimet e saj kjo platformë u mbështet shumë në potencialin tregtar midis Kinës dhe Shqipërisë. Në fakt, Kina mbetet një nga

partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë dhe në kuadër të marrëveshjes Kinë-EQL ka pasur progres në nivelin e komunikimit, por ka ende një potencial të madh që duhet shfrytëzuar.

Angazhimi i nivelit të lartë qeveritar ka qenë në qendër. Kryeministri shqiptar ka marrë pjesë në 7 nga 9 takime [Bukuresht 2013, Beograd 2014, Suzhou 2015, Riga 2016, Sofje 2018, Dubrovnik 2019, Pekin virtual 2021]. Vetëm në dy raste ka marrë pjesë zëvendëskryeministri [Varshavë 2012, Budapest 2017]. Kështu, kjo krijoi një mundësi tjetër për liderët përkatës për të shkëmbyer ide dhe për të koordinuar politikat. Në vazhdim të lehtësimit të ndërlikimit midis vendeve, që prej muajit mars 2023, shqiptarët mund të udhëtojnë në Kinë pa viza, dhe e anasjellta, dhe kjo u nis vite më parë, në një takim të platformës Kinë-EQL.

Bashkëpunimi Kinë-EQL po krijon bazat për intensifikimin e marrëdhënieve në të ardhmen mbi bazën e njohjes reciproke të kombeve. Kontaktet e intensifikuara na bëjnë më të prirur për të kuptuar dhe pranuar realitetet e njëri-tjetrit. Rëndësia e dialogut dypalësh qëndron përtej elementit politik, dhe Kina-EQL duket se e kanë siguruar këtë. Dialogu ndërqeveritar i kulturës/ tregtisë/ investimit dhe veçanërisht nënshkrimi i marrëveshjeve hapin një dritare komunikimi dhe krijojnë një lloj historie të përbashkët për shkëmbim të ndërsjellë në të tashmen dhe të ardhmen. Nuk ka përse të mos mbështetet.

Përprojekjet në nivel diplomatik të Kinës kanë qënë të shumta për të veshur me “kapital shtetëror” atë që mund të bëhet në terren më kapital njerëzor dhe ekonomik. Duhet nënvizuar së Ambasada e RPK-së në Shqipëri ka qënë jashtëzakonisht proaktive në nxitjen dhe promovimin e çdo lloj bashkëpunimi dhe komunikimi midis vendeve në kuadër të BRI-së, Kinë-EQL dhe më gjerë.

Por jo vetëm kaq, më 29 tetor 2021, Këshilltari i Shtetit dhe Ministri i Jashtëm kinez Wang Yi mbërriti në Shqipëri për një vizitë zyrtare shtetërore. Në axhendën e ministrit ishin tre takime të nivelit të lartë dhe një nga fjalët kyçe që ai përdori në këtë takim me autoritetet shqiptare ishte “motor i dyfishtë”. Kina do të mbështesë gjerësisht efektet shtytëse të BRI-së dhe platformës Kinë-EQL për t'u shërbyer vendeve të rajonit për të arritur atë që dëshirojnë më shumë. Dhe Ministri Wang theksoi se duhet të punojmë së bashku për të përkthyer potencialin për bashkëpunim në rezultate të prekshme. Ky “motor i dyfishtë” është mënyra më efikase për të arritur rezultatet e dëshiruara. Nga perspektiva e një vendi të vogël dhe një perspektivë e vendit në zhvillim, ajo që këto nisma ofrojnë duhet të jenë joshëse për ekonomistët dhe politikëbërësit.

Duke cituar ish-ambasadorin shqiptar në Kinë, z. Hajdar Muneka, pjesëmarrja e vendeve relativisht të varfëra, si Shqipëria, në nismat kineze është një mundësi e artë për zhvillimin e tyre, por edhe kjo kërkon angazhim serioz.



Si nismëtare e kësaj iniciative, Kina ofron shumë, por secili duhet të investohet seriozisht e me kapacitete të plota për zhvillimin e vendit të tij.

Si një njohës i shkëlqyer i Kinës dhe i ritmeve të diplomacisë dhe projekteve kineze, Muneka sugjeron me mprehtësi dhe kthjelltësi për politikëbërësit e vendit të tij: *“Treni kinez ecën me shpejtësi të jashtëzakonshme. I fituar është ai vend që arrin të ndërtojë një stacion të këtij treni në vendin e tij.”*

Analogjitë mekanike të motorit dhe trenave për ritmet e rrugës kineze nuk janë të rastësishme. Kush e njeh Kinën e di se atje nuk ka as humbje kohe, as humbje dëshire, e aq më pak ngadalësim veprimi. Projektet dhe nismat kineze janë një makineri e pandalshme drejt modernizimit që duhet të jenë

atraktive në vendet në zhvillim.

Së fundmi, perceptimi, qasja dhe gjykimi kundrejt çdo vendi të madh në një vend të vogël duhet të bëhet në baza të vlefshme analitike dhe pa nuanca tendencioze, pasi nuk e lejon një vend të marrë vendimet e duhura në raport me të tjerët. Ka një tendencë disa vjeçare, jo vetëm në Shqipëri por në gjithë Ballkanin Perëndimor, ku është e qartë dikotomia në diskursin publik prezencë-influencë.

Kur flitet për vendet e zhvilluara Euro-Atlantike fjala e përdorur është “prezencë”, kur flitet për Kinën, fjala më e përdorur është “influencë”. Kjo nuk është as e saktë, as produktive dhe as e nevojshme. Nëse ka një kohë të volitshme ku pragmatizmi duhet të triumfojë mbi dogmatizmin, ajo kohë është sot.

# Dinamikat Globale, Perspektiva Kineze

Dr. Marsela MUSABELLIU

Për dekada, demokratizimi i politikës globale është bërë një temë e rëndësishme e agjendës ndërkombëtare. Duket qartë se çfarë nevojitet më shumë se kurrë është mundësia e pjesëmarrjes së të gjithëve dhe intensifikimi i bashkëpunimit në nivele të shumta të qeverisjes globale.

Jetjohmë në një moment të përshtatshëm në histori, për të shqyrtuar dinamikat në ndryshimet globale. Me rritjen e shpejtë të Kinës, me kushtet kaotike në mbarë botën, ato të sigurisë, të paqes dhe zhvillimit njerëzor, është me rëndësi të madhe që roli i Kinës së pari të kuptohet dhe së dyti të vlerësohet.

Për ta kuptuar atë, është më mirë të mbështetemi në burime kineze, në vend të interpretimeve të tjerëve, të cilat janë kryesisht të njëanshme dhe politike. Për t'a vlerësuar si duhet, mjafton të shohim qasjen e Kinës në arenën ndërkombëtare me disa fjalë/fjali si komuniteti me fate të përbashkëta të njerëzimit, bashkëpunim me përfitime të ndërsjella, multilateralizmi i vërtetë, mosndarja e botës në blloqe, refuzimi i "mentalitetit të Luftës së Ftohtë"..etj.

Por, si u arrit këtu, dhe si mund të shpjegohet më mirë udhëtimi i Kinës për një audiencë globale? – Le ta nisim me një ndarje në faza historike. Profesor Feng Zhongping, Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Studimeve



Ambasadorja Jiang Yu gjatë aktivitetit të bashkëpunimit ekonomik për promovimin e produkteve shqiptar, 10 nëntor, Tiranë(Foto:CMG)



*Kina do të mbështesë gjerësisht efektet shtytëse të BRI-së dhe platformës Kinë-EQL për t'u shërbyer vendeve të rajonit për të arritur atë që dëshirojnë më shumë. Dhe Ministri Wang theksoi se duhet të punojmë së bashku për të përkthyer potencialin për bashkëpunim në rezultate të prekshme. Ky "motor i dyfishtë" është mënyra më efikase për të arritur rezultatet e dëshiruara.*



Evropiane në Akademinë e Shkencave Sociale të Kinës (CASS) dhe President i Institutit Kinë-EQL, e ndan rrugën e Kinës në tre faza.

Faza e parë përfshin tridhjetë vitet e para, që janë ato të

pavarësisë. Kjo zgjati nga themelimi i RPK-së në 1949 deri në vitin 1979. Në këtë kohë, fokusi i Kinës ishte vetëvendosja, autonomia, fokusi i brendshëm dhe më shumë vëmendje në këtë fushë të pavarësisë.

Faza e dytë, duke filluar nga viti 1979 deri në vitin 2009, është ajo e integritit. Në këto dekada, Kina po lidhej me pjesën tjetër të botës dhe bota po zbulonte Kinën. Faza e tretë vjen në pikën e kthesës, në vitin 2009 deri më sot, ajo që Prof. Feng e quan faza ku Kina është duke sjellë më shumë kontribut në formësimin e rendit botëror. Ndërsa bota priste që Kina të bënte më shumë, që nga ai vit e deri më sot, Kina po kontribuon më shumë në të mirat publike, me disa iniciativa sipas nevojave të kohës dhe duke krijuar kështu një rrjet global partneriteti.

Në të vërtetë, pas vitit 2009, ka pasur një varg deklaratah e iniciativash dhe Kina po i flet botës disi më ndryshe nga më parë. Arritjet e saj ekonomike, rritja e mirëqenies dhe



Produkte shqiptare të mirëpritura në tregun kinez që paraqiten në aktivitetin e bashkëpunimit ekonomik (Foto:CMG)

çrrënjësja e varfërisë tani po i prezantohet botës me një perspektivë për të ardhmen. Kina mendon globalisht, nuk mendon ngushtë, nuk mendon as rajonalisht.

Pekini zyrtar po përpiqet të adresojë problemet globale me idenë e “fatit të përbashkët” të njerëzimit. Në vend që të konsiderohet si rivalitet, ajo duhet të konsiderohet se ofron një fener shprese me përvojën e saj, me rrugën drejt modernizimit dhe nismat e fundit globale për siguri, zhvillim dhe qytetërim.

Kina përfaqëson një forcë stabiliteti në një botë plot pasiguri, dhe kjo është tërheqëse për ato vende që duan paqe e zhvillim. Shumica e kombeve janë të kënaqura me aktivizmin kinez dhe shprehjen më të zëshme të interesit kinez, sepse u ofron atyre alternativa për zhvillim dhe modernizim.

Pse është joshëse? – sepse Kina flet për çështjet që me të vërtetë kanë rëndësi për njerëzit, zhvillim, modernizim, bashkëpunim me përfitim të

ndërsjellë...këto janë prioritare për shumicën dërrmuese të njerëzve dhe të kombeve. Kina po promovon dhe mbështet në mënyrë të pareshtur multilateralizmin e vërtetë. Gjatë dekadës së fundit, Kina ka ngritur disa platforma aktive të multilateralizmit, të cilat kanë nxitur ndërveprim të intensifikuar midis institucioneve, qytetarëve dhe qeverive.

Aktualisht, Kina shfaq përvojën, synimet, mjetet dhe garancitë për të ardhmen.

Përvoja – Duke filluar me Iniciativën “Një brez, një rrugë” (BRI), Iniciativën për Zhvillimin Global (GDI), Iniciativën e Qytetërimit Global (GCI) dhe më shumë, Kina është instrumentale, proaktive dhe në përputhje me atë që shumica duan në formësimin e së ardhmes së multilateralizmit të vërtetë. Megjithatë, ato duhet të shihen në terma afatgjatë, sepse janë një mënyrë e të menduarit për botën duke identifikuar si prioritete, një mënyrë të qëndrueshme për t'u zhvilluar

më tej.

Mjetet/mënyrat - Qasje proaktive, Kina i inicioi ato dhe po i nxit, i promovon dhe po i zgjeron ato nisma, të cilat kanë potencialin të bëhen një motor i fuqishëm i rritjes dhe përmirësimit të ekonomisë, duke u shërbyer vendeve që janë pjesë e saj për të arritur zhvillim të mëtejshëm.

Synimet – agenda diplomatike kineze po intensifikohet çdo ditë në shkallë globale, në mjedise formale dhe joformale, dhe diskursi që dëgjojmë është jashtëzakonisht inkurajues. Dëgjojmë fraza të tipit “Vendet në zhvillim e “bartën” Kinën në OKB; Kina ka vepruar në të njëjtën frymë duke folur për botën në zhvillim.” Ose, «Përballë hendekut global të financimit të zhvillimit, Kina i bën thirrje komunitetit ndërkombëtar të bashkëpunojë sinqerisht dhe të punojmë së bashku për të zgjidhur problemet e vendeve në zhvillim, veçanërisht të vendeve të varfra». Të thëna në platforma globale, qëndrimet rezonojnë thellë dhe këto fraza



**Përvoja – Duke filluar me Inicativën “Një brez, një rrugë” (BRI), Inicativën për Zhvillimin Global (GDI), Inicativën e Qytetërimit Global (GCI) dhe më shumë, Kina është instrumentale, proaktive dhe në përputhje me atë që shumica duan në formësimin e së ardhmes së multilateralizmit të vërtetë. Megjithatë, ato duhet të shihen në terma afatgjatë, sepse janë një mënyrë e të menduarit për botën duke identifikuar si prioritete, një mënyrë të qëndrueshme për t'u zhvilluar më tej.**

impaktojnë shumë vendet që kanë nevojë të dëgjohen në skenën ndërkombëtare.

Garanci - Vazhdimësia e udhëheqjes kineze është një garanci se gjatë rrugës, Kina ka qenë dhe do të jetë konsistente në ndërveprimet e saj me pjesën tjetër të botës.

Si po paraqitet Kina në botë gjatë dekadës së fundit? – Angazhimi

i Kinës për të punuar me pjesën tjetër të botës, drejt “komunitetit të së ardhmes së përbashkët për njerëzimin” ripohon politikën e saj të jashtme afatgjatë për paqe dhe prosperitet, dhe ky vizion kinez nuk është një skemë gjeopolitike për të gdhendur sfera influence, por përfaqëson ndjekjen e aspiratave të shumë popujve në botë për

bashkëpunim dhe jo varësi.

Krijimi i një komuniteti të së ardhmes së përbashkët për njerëzimin buron nga kultura tradicionale kineze dhe filozofia e saj disa-shekullore e harmonisë dhe unitetit. Presidenti Xi këtë vizion të Kinës e përshkroi me pesë drejtime “politike, sigurie, ekonomike, kulturore dhe ekologjike” dhe ai bën thirrje për krijimin e një “komuniteti... që është i hapur, gjithëpërfshirës, për një botë të pastër dhe të bukur që gëzon paqe të qëndrueshme, siguri universale dhe prosperitet të përbashkët.” Ajo që Kina mbron në dimensionin gjeopolitik është një botë sovraane e orientuar në barazi, ku mosmarrëveshjet zgjidhen përmes dialogut dhe paqja ndërtohet mbi partneritete në vend që të zbatohet përmes aleancave ushtarake apo forcës politike. Por, çfarë do të thotë në praktikë kjo qasje kineze në skenën ndërkombëtare? – Shumë shpesh dëgjohet nga politikëbërësit kinezë shprehja “konsultime të gjera, kontribut të përbashkët dhe përfitime të përbashkëta”. Kina po u drejtohet vendeve të tjera duke thënë se së bashku ndërtojmë rregullat e lojës, së bashku punojmë dhe po bashkë ndajmë frytet e bashkëpunimit. Asnjë vend nuk mund të trajtojë i vetëm sfidat e shumta me të cilat përballet njerëzimi; asnjë vend nuk mund të përballojë që të rrijë në izolim. Por ndërkohë që në Kinë deklaratat janë drejt botës për respekt kulture, historie, rrethanash dhe çdo gjë tjetër, e njëjta gjë kërkohet nga pjesa tjetër e botës kundrejt Kinës, dhe etiketimi, kategorizimi dhe përshkrimi sipërfaqësor nuk kanë vend, sidomos kur shihet



sistemi politik.

Si bashkëjetojnë vazhdimësia me ndryshimin në sistemin kinez? - Sistemi politik i Kinës, sidomos në Perëndim, shikohet si antitezë e aktualitetit dhe shpesh herë merret si pikë referimi për të justifikuar mungesën e dëshirës për bashkëpunim. Por në fakt, Socializmi me Karakteristika Kineze ka prodhur më shumë mirëqenie, më shumë efektivitet të qeverisjes, dhe në fund të fundit në Kinë e dinë shumë mirë se substanca është më e rëndësishme se forma.

Një vend me më shumë se 1.4 miliardë banorë nuk mund të qeveriset mirë pa institucionet e duhura, të shëndosha dhe të qëndrueshme. Institucionet politike si bartëse dhe zbatuese të vullnetit të popullit përfaqësojnë ambicien dhe realitetin e një kombi. Dhe qëllimi përfundimtar i një liderशिpi të suksesshëm është të kombinojë në mënyrë harmonike aspiratat kombëtare, sociale dhe individuale.

Marrëdhënia midis shtetit dhe shoqërisë në Kinë është e ndryshme nga ajo në Perëndim. Në Kinë, shteti gëzon shumë legjitimitet, shumë autoritet dhe shumë miratim nga qytetarët, sepse mbart një kuptim të veçantë si përfaqësues, mishërues dhe mbrojtës i kombit.

Në këtë modernizim kinez, aspiratat e njerëzve kanalizohen përmes angazhimeve qeveritare për përparim. Është një linjë mendimi dhe veprimi në të cilën njerëzit kanë rëndësi dhe shqetësimi kryesor është se cila është ideja më e mirë e përparimit dhe si të arrihet ajo. Sistemi si i tillë është një plan i asaj që i përshtatet më mirë realitetit të



Konferenca e parë e nivelit të lartë e Forumit mbi Veprimin Global për Zhvillim të Përbashkët, Pekin, 10 korrik 2023. /Xinhua

një kombi dhe çfarë plotëson më mirë nevojat e qytetarëve, nëpërmjet përkushtimit për avancimin e drejtësisë sociale dhe mirëqenies së përgjithshme njerëzore.

Në Kinë qeveria përmbush pritshmëritë e njerëzve nëpërmjet një selektimi rigoroz të zyrtarëve, nëse do të shohim vetëm nivelin, sfondin dhe CV-në e njerëzve që qeverisin Kinën, atëherë do të kuptohet se kapaciteti i tyre përputhet me pritshmëritë dhe projeksionet e vendit. Pjesëmarrja e njerëzve dhe përmirësimi social dhe material kanë qenë përvoja të jashtëzakonshme që Kina i ka demonstruar botës. Numrat nuk gënjejnë kurrë, 800 milionë njerëz që nxirren nga varfëria brenda disa dekadave është një arritje e jashtëzakonshme me çdo kalibër matës dhe me çdo lupë të shihen.

Vendosja e qëllimeve afatgjata, objektivave afatmesme dhe afatshkurtra që monitorohen dhe modifikohen vazhdimisht, dhe vënia në praktikë e konceptit të hierarkisë, meritokracisë dhe vizionit të mirëstrukturuar

- ky është plani i një historie suksesi. Përveç përshtatjes ndaj situatave në ndryshim, Kina ruan gjithashtu vazhdimësi në strategjitë e mëdha dhe aplikimin e socializmit me karakteristika kineze. PKK-ja ka udhëhequr transformimin e gjithanshëm të vendit për më shumë se shtatë dekada, duke lënë një gjurmë të thellë në modernitetin e Kinës dhe më gjerë.

Mrekullia ekonomike e Kinës nuk ndodhi rastësisht. Ajo u zhvillua drejtpërdrejt nga politikat e nisura, zbatuara dhe vëzhguara nga qeveria në nivel qendror, rajonal dhe lokal. Një nga mjetet më të fuqishme të politikës që Kina ka dhe do të vazhdojë të ketë, është përshtatja ndaj ndryshimeve dhe reformave.

Mënyra se si politikëbërja kineze është përballur me ndryshimet dhe transformimin duhet të analizohet në kontekstin e asaj se si Kina e sheh veten, jo se si e sheh bota Kinën.

T'ju japësh njerëzve mirëqenie do të thotë t'ju japësh atyre dinjitet, t'i japësh popullit dinjitet do të thotë ti japësh kombit lavdi, dhe kjo është për t'u admiruar.

# PIKË MADHORE REFERENCE GJEOPOLITIKE PËR KINËN!



Dr. Jorgji KOTE

**P**o, mjafton të lexosh faktet e mëposhtme dhe binde sh se kjo pikë madhore gjeopolitike, e cila ndihmon shumë për të kuptuar sjelljet dhe qëndrimet gjeopolitike kineze dhe zbatimin e strategjitë të duhura perëndimore për t'i bërë ballë me sukses sfidave të sotme madhore kineze, është ish Kan-

celari i shquar gjerman Helmut Schmidt (1918 – 2015).

Fillimisht sqarojmë se Schmidt në Gjermani konsiderohet “kancelar i zemrave”, në sondazhet e zhvilluara ai renditet mbas Adenauer-it. Është ndër të paktët politikanë multidisiplinorë gjermanë dhe botërorë në fushën e Europianizmit, financave, mbrojtjes dhe sigurisë, ideatori i Euro bashkë me mikun e tij të jetës, ish Presidentin francez Giscard d’Estaing; themelues i G-7, ideatori dhe lançuesi i “vendimit të dyfishtë” ndaj Ruisë në vitet 80, domethënë negociata me ish Bashkimin Sovjetik të shoqëruara me vendosjen e raketave amerikane “Persching”.

Mjeshtër i papërbalueshëm i fushatave zgjedhore, orator i rrallë i mbiquajtur “gjuhëshpati” dhe

pragmatist ose “bërës” (macher). Politikan me integritet të padiskutueshëm, për të cilin nuk pati asnjë aludim apo insinuatë për ndonjë aferë ose skandal.

Si një përjashtim i vetëm, Akademisë Ushtarake në Hamburg që ai themeloi i dhanë emrin e tij qysh për së gjalli. Përbën ndër rastet e rralla në botë kur 32 vjet pas largimit nga politika aktive deri ditën që mbylli sytë, u bë dhe më i famshëm falë aktivitetit të tij publicistik me 30 “best seller” me qindra shkrime dhe ligjërata në botë mbi aktualitetet e nxehta në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Nisur nga këto vlera të personalitetit të tij poliedrik, si burrë shteti i një vendi të madh si Gjermania, Schmidt ishte këshilltar dhe pikë referimi për politikanët më

të lartë gjermane, të majtë dhe të djathtë dhe jashtë Gjermanisë, ” njeriu më i mençur në botë” siç e ka cilësuar miku i tij i ngushtë politik Dr. Henry Kissinger.

Theksojmë se në veprimtarinë e tij derisa u nda nga jeta në Dhjetor 2015, Kina zë vend të veçantë. Eksperti sinolog i DW, Frank Sieren thotë se ” askush tjetër, veç Kissingerit nuk është marrë aq herët, aq gjatë dhe me me aq shumë interes me Kinën sa Kancelari Helmut Schmidt”, plot 40 vjet në nivelet e saj më të larta.

Ishte i pari Kancelar gjerman që vizitoi zyrtarisht Pekinin më 1975, ku takoi Mao Ce Dunin ( shih foton më poshtë) dhe liderët e tjerë të lartë. Këto vizita dhe takime ai i vijoi dhe mbas largimit nga politika aktive.



Në vitin 1990, sërish ishte politikan i parë i lartë perëndimor që shkoi në Kinë si ndërmjetësues dhe takoi Ten Hsiao Pinin (shih foton më poshtë), në përpjekje për forcimin e krahut reformator. Idetë dhe mendimet e tij mbi Kinën u vlerësuan dhe nga Presidenti amerikan George Bush.



Më vonë, më 2003, ai u takua në Panairin e Hanovrit me Kryeministrin Wen Jiabao. Për herë të fundit, megjithë moshën e thyer 94 vjeçare ai e vizitoi Pekinin më 2012, ku takoi ish Kryeministrin Zhu Rongji dhe Presidentin e ardhshëm Xi Jinping. Ky i fundit, gjatë vizitës së tij të parë zyrtare si President në Mars 2014 në Berlin kërkoi dhe zhvilloi takim me Schmidt. ( shih foton më lart)

Schmidt ka theksuar në disa intervista dhe veprimtari publike se interesi dhe vizitat e tij në Kinë nuk lidhen me ndonjë pasion turistik, historik apo ndonjë sinofobi të tij. Arsyeja kryesore është se duke e njohur mirë Kinën, Gjermania dhe Europa mund të hartojnë dhe zbatojnë strategji dhe programe veprimi efektive.

Këto fakte tregojnë se analizat dhe qëndrimet afat-gjatë në marrëdhëniet me Kinën kërkojnë de-tyrimisht t'i drejtohem veprës dhe ndihmesës së jashtëzakonshme të Helmut Schmidt. Ndaj, më poshtë po ndalemi në disa nga mësimet dhe përfundimet e tij kryesore mbi Kinën.

Së pari, Schmidt thekson me keqardhje hendekun midis njohjes me të mirë të lidhshpimit të lartë

kinez të Perëndimit dhe të këtij të fundit me plot mangësi mbi Kinën. Deficitet perëndimore në njohjen e problematikave, veçorive, dallimeve dhe zhvillimet kineze shpjegojnë dobësitë në politikat dhe qëndrimet ndaj Kinës.

Së dyti, Schmidt nënvizon vlerat e shumta të qytetërimit 5 mijë vjeçar kinez, që ndryshe nga qytetërimet e tjera të famshme që janë zhdukur me kohë ka mbetur i gjallë dhe vital. Me këtë rast ai rikujton se në Shekullin e XV Kina ishte në kulmin e këtij qytetërimi, nga ndërtimi i anijeve, shtypshkronjat e deri te teknologjitë ushtarake. Ky zhvillim shkoi më vonë në Europë dhe në Amerikën Latine.

Së treti, me shumë rëndësi është fakti se qytetërimi kinez në përgjithësi ka patur karakter paqësor, duke mos i rënë në qafë askujt. Kina nuk ka patur asnjëherë synime dhe dukuri imperialiste dhe pushtuese. Ai sjell shembullin e Admiralit të famshëm kinez në shekullin e XV, Zheng He, i cili nuk e përdori asnjëherë flotën detare për të sulmuar të tjerët.

Përkundrazi, vendet e tjera koloniale perëndimore, ndërmjet të



“Europa duhet të realizojë synimet e saj në botë në bashkëpunim me Kinën”. Këtu na vjen ndërmend debati që lindi pas kthimit të Presidentit Macron nga vizita e tij në Pekin më 7 Prill 2023 kur deklaroi se Europa duhet të ketë politikën e saj kundrejt Kinës, të pavarur nga SHBA-të, çka krijoi debate dhe diskutime të shumta.



cilave dhe Gjermania, Japonia, dihet se bënë invazione koloniale në Kinë. Schmidt depërton thellë në zhvillimet e saj deri me ardhjen në pushtet të komunistëve me Mao Ce Dunin dhe zhvillimet kineze deri në vitin 1990. Ai e vlerëson Kryetarin Mao si ”njeri shumë impulsiv, karizmatik, që nuk të hiqet nga mendja dhe me dhunti”. Gjithsesi, ai kritikon lëvizjen e madhe politike të viteve 50 dhe Revolucionin Kulturor. Ndërkohë, vlerëson reformat ekonomike të Ten Hsio Pinit, të cilin e konsideron udhëheqësin më të madh komunist të të gjithë kohërave.

Së katërti, Schmidt evidenton prirjet e sotme të Kinës, në përpjekje për të kombinuar sa më drejt komponentët dhe aspektet tradicionale me zhvillimin modern të një vendi super të madh,



larg nacionalizmit dhe konfrontimit që janë me pasoja për një vend të tillë gjigand. Ai shprehet i mahnitur nga përparimet e mëdha të realizuara sidomos gjatë dhjetëvjeçarit 2010 – 2020, duke dhënë si shembull dyfishimin e të ardhurave për frymë! Po ashtu, Schmidt evokon përparimet në fushën e industrializimit të një lloji të veçantë, arritjet në fushën e teknologjisë, modernizimit të bujqësisë, teknologjisë, etj. Në këtë kuadër ai evidenton Presidentin Xi Jinping dhe synimet e tij strategjike për të realizuar ëndrrën kineze, dëshirën për paqe, reformimin e Partisë, socializmin kinez, luftën kundër korrupsionit, mbrojtjen e mjedisit, luftën ndaj smogut, etj.

Së pesti, një përfundim interesant është se kinezët vërtet kanë ”robëruar botën”, por pa dhunë ushtarake. Schmidt le të nënkuptojë se do të ishte mirë që miqtë amerikanë të kishin mësuar dhe të vepronin po kështu!

Më tej, Schmidt sugjeron që Perëndimi është më mirë të heqë dorë nga arroganca dhe dhënia e leksioneve për udhëheqjen e lartë të Kinës. ”Do të ishte më e udhës

që ai ta zëvendësonte arrogancën me konkurrencën e ndershme”.

Së gjashti, sipas tij, “Europa duhet të realizojë synimet e saj në botë në bashkëpunim me Kinën”. Këtu na vjen ndërmend debati që lindi pas kthimit të Presidentit Macron nga vizita e tij në Pekin më 7 Prill 2023 kur deklaroi se Europa duhet të ketë politikën e saj kundrejt Kinës, të pavarur nga SHBA-të, çka krijoi debate dhe diskutime të shumta. Kjo tezë, pavarësisht nga kundërshtitë, ka logjikën e saj, sepse dihet se Europa, Gjermania, Franca, etj kanë krijuar për fajin e tyre një varësi të jashtëzakonshme ekonomike dhe tregtare nga Kina, shumë më të madhe se nga Rusia. Kështu që dhe në qëndrimet ndaj Kinës do ndjekur parimi “mat shtatë herë dhe prit njëherë”. Ndaj dhe Gjermania kohët e fundit po bën demarshe të gjithanshme në Brazil, me qëllim që të konkurrojë ekonomikisht me projekte me Kinën, ashtu si dhe BE-ja që ka shpalosur programin e saj me 600 miliard Euro në Afrikë, Azi dhe Amerikën Latine, si kundërpeshë ndaj nismës kineze ” Një

brez, një rrugë”.

*Së shtati*, një komponent tjetër i rëndësishëm është ai që ka të bëjë me kërkesat dhe trysninë perëndimore për të drejtat e njeriut, çështjet e Tibetit, të Xinjiang-ut etj. Për këtë, Schmidt tha se ”unë nuk kam të drejtë t’u kërkoj të tjerëve të zbatojnë këto të drejta, të cilat nuk janë universale”.

Në fakt, pavarësisht nga rezervat dhe kundërshtimet normale në demokraci, këtu praktika ka treguar se Schmidt si politikan pragmatist ka të drejtë. Fakt është se presioni ndërkombëtar perëndimor ndaj Kinës në 34 vitet e fundit nuk ka munguar dhe është shprehur në të gjitha vizitat

e niveleve më të larta në Pekin dhe në metropolet Euro-Atlantike dhe me sanksione të shumta. Por, rezultati është pothuajse asgjë, sepse Kina në të drejtën e vet thotë se ka standardet e veta dhe në këtë fushë, sikurse dhe demokracinë e saj alternative konsultative. Dhe se demokracia liberale perëndimore nuk është dogmë, madje ajo po rrudhet dhe në vetë vendet më të përparuara perëndimore në favor të ekstremizmit, populizmit dhe ”izmave” të tjerë negativë. Për të qenë të sinqertë, në epokën e globalizmit, kur ti kërkon të nxjerrësh sa më shumë përfitime ekonomike dhe tregtare nga Kina dhe vende të tjera të mëdha si Brazili, India, etj dhe nga ana tjetër ta kushtëzosh këtë

me diplomacinë etike, dmth me respektimin prej tyre të të drejtave të njeriut, kjo mund të jetë e drejtë në parim, por në praktikë nuk funksionon.


Në përfundim, kanë kaluar rreth 8 vjet qëkurse i ndjeri Kancelari Schmidt ka mbyllur sytë. Por, pavarësisht nga nuancat e rastit, logjika gjeopolitike, argumentat dhe sugjerimet strategjike të ish Kancelarit emblematik gjerman mbi Kinën dhe gjeopolitikën e saj, natyrisht me përshtatjet e rastit mbeten të drejta dhe të vlefshme. Tanimë, përpunimin e ideve dhe mendimit të tij politik me dinamikat e rastit i vijon me objektivet historik Fondacioni prestigjioz ” Helmut Schmidt”

## “Gjynahet” kineze dhe “mëkatet” perëndimore!

Dr. Jorgji KOTE

**K**ohët e fundit janë shtuar përpjekjet dhe demarshet diplomatike për uljen e toneve dhe tensioneve politike, ekonomike dhe ushtarake midis SHBA-ve/Perëndimit në përgjithësi dhe Kinës pas akuzave të ndërsjella, incidenteve në Ngushticën e Tajvanit, Detin e Kinës Jugore, me anije dhe avionë luftarakë, etj.

Në fakt, nisur nga serioziteti i gjendjes, është e nevojshme dhe urgjente të mendohet thellë dhe të veprohet më me shpejtësi dhe diplomaci. Veçse kjo kërkon gjykim objektiv realpolitik, pa paragjykime dhe nga pozita



të barabarta. E theksojmë këtë, sepse pavarësisht nga faktet dhe argumentat që jep Perëndimi për të shpjeguar shqetësimet e tij

gjeostrategjike kundrejt Kinës, ai vetë ka vend për reflektim të ”gjynahet” e veta, siç po bën dhe mbi problemet, mungesat



dhe pengesat që ai ka dhe krijon, pa ” treguar gishtin” vetëm te ” mëkatet ” kineze.

Le ta fillojmë analizën tonë duke pohuar se pavarësisht shqetësimeve të drejta gjeopolitike që bart dalja e Kinës me pretendimet e saj si superfuqi botërore, shumë probleme dhe telashe në botë nuk kanë autorësinë e saj. Kjo mund të thuhet për konfliktet në Lindjen e Mesme, në Amerikën Latine e deri te Ballkani Perëndimor në përgjithësi, e sidomos Dialogu Serbi – Kosovë dhe tensionet më të fundit midis tyre. Në fakt, askund nuk gjen ndonjë gjurmë kineze në qorrsoakun e atjeshëm.

Përmendet shpesh se Kina nuk njeh Kosovën. Po mirë, po pse të shkojmë deri në Kinë, ku gjithësesi dihet ndjeshmëria ndërkom-bëtare për Tajvanin dhe politikën “Një Kinë” dhe nuk përmendet pothuajse fare se të keqen e kemi nga brenda BE-së! Jo një, por plot 5 vende anëtare as nuk denjojnë ta njohin Kosovën!

Në këtë kuadër, SHBA-të, Gjër-

mania dhe vende të tjera të BE-së po veprojnë mirë që po bëjnë kthesën e duhur, duke hequr dorë me lezet dhe gradualisht nga kërkesat këmbëngulëse ndaj Kinës. Kjo u pa dhe në takimet e Sekretarit të Shtetit Blinken në Pekin më 18 – 19 Qershor.

Pastaj, le të jemi të sinqertë, shteti i të drejtës është bërë kritik

**Shteti i të drejtës është bërë kritik dhe sfidë e vështirë dhe për vetë SHBA-të/ BE-në. Fuqia e saj joshëse dhe frymëzuese, për shkak të përshkallëzimit të demokracisë joliberalë, populizmit, ekstremizmit, nacionalizmit dhe plot “ izmave” të tjerë është zbehur ndjeshëm në këto 20 vitet e fundit.**

dhe sfidë e vështirë dhe për vetë SHBA-të/ BE-në. Fuqia e saj joshëse dhe frymëzuese, për shkak të përshkallëzimit të demokracisë joliberalë, populizmit, ekstremizmit, nacionalizmit dhe plot “ izmave” të tjerë është zbehur ndjeshëm në këto 20 vitet e fundit.

Për rrjedhojë, në strategjinë e tij të parë të sigurisë kombëtare, të miratuar më 14 Qershor 2023, në marrëdhëniet e saj me Kinën dhe vende të tjera jo perëndimore, Berlioni zyrtar do t’i referohet kryesisht Kartës së OKB-së.

Përveç sa më sipër, momenti kur Kinës i bëhen presione në këtë fushë nuk është më i favorshëm për Perëndimin si në fillimin e viteve 90; besueshmëria e tij është gërryer shumë vitet e fundit. Madje, telashtet demokratike janë shtuar dhe për vetë SHBA-të me një katalog të dhimbshëm dukurish të frikshëm. Mjaft të përmendim zgjedhjen e Trump President më 2017, 37 akuzat e tanishme ndaj tij e megjithatë mundësia për të rifituar në zgjed-

hjet presidenciale 2024, sulmin e armatosur mbi Capitol Hill më 6 Janar 2021, tensionet me racizmin, përshkallëzimi i dhunës me armë zjarri ku çdo vit vriten 40.000 vetë, shumica fëmijë dhe nxënës, etj.

Jo më e mirë paraqitet gjendja dhe brenda BE-së. Veç "izma-ve" të lartpërmendur, ekstremi i djathtë ka ardhur në pushtet në Itali, Suedi dhe Finlandë; ndërkohë ai vazhdon të fitojë terren në Francë, Gjermani, Spanjë dhe gjetkë. Sa për anëtarësimin në BE që trumpetohej me bujë dhe nga Selaniku 20 vite më parë, atij ka kohë që "po i xhirojnë gomat në baltë"

Perëndimi ka pësuar dështime dhe përsa i përket sigurisë rajonale dhe kontinentale. Rikujtojmë tërheqjen e tij kaotike nga Afganistani, Libia, Iraku dhe Siria. E pra Kina nuk ka patur fare gisht në këtë drejtim, pasi Perëndimi atje kishte në dorë siç thuhet rëndom "gurin dhe arrën!".

Vitet e fundit, vendet perëndimore, sidomos SHBA-të nuk kanë dhënë shembull të mirë as në fushën e diplomacisë shumëpalëshe. Kulmi arriti gjatë Presidencës Trump, kur SHBA-të u larguan nga 10 organizata dhe traktate të rëndësishme ndërkombëtare. Të kundërtën bëri Kina, e cila natyrisht që nuk kishte se si t'i linte bosh këto hapësira, duke aderuar në to në favor të shumëpalëzimit.

Ndërkohë, përse të mos e themi se vitet e fundit SHBA-të dhe Perëndimi në përgjithësi, në vend të një diplomacie shtensionuese me Kinën, janë marrë më shumë me akuza dhe provokime të panevojshme dhe me demonstrime force ndaj saj. Kështu, nuk kishite pse ish Kryetarja e Kongresit


amerikan Nancy Pelosi të shkonte në Tajvan vitin e kaluar dhe të nxiste në kulm tensionet politike dhe ushtarake. Kishte dhe ka mënyra të tjera për të vepruar në këto fusha me ndjeshmëri të jashtëzakonshme politike dhe diplomatike.

Ose si në rastin e Ministrisë kineze të Mbrojtjes, Li Shangf, i cili më 2018 u vendos në listën e sanksioneve amerikane; e megjithatë, disa javë më parë iu kërkua takim nga homologu amerikan, të cilin ai e refuzoi me mirësjellje. Lidhur me këtë, Dennis Wilder, sinolog në Universitetin Georgetown në Uashington shtron pyetjen nëse homologu i tij amerikan Austin do ishte në listën kineze të sanksioneve, a mund të shkonte të takonte homologun kinez? Natyrisht që jo!

Edhe për shpenzimet ushtarake, mund ta kritikosh Kinën, por të njëjtën gjë, madje në masë

më të madhe po bën dhe vetë Perëndimi. Kështu, të dhënat zyrtare tregojnë se shpenzuesi më i madh ushtarak më 2022 ishin SHBA-të me 877 miliard Dollarë, baraz me 39 për qind të shpenzimeve globale, më e madhe se e tetë vendeve të saj aleate të marra së bashku! Ndërsa Kina zë vetëm 13 për qind të tyre!

Padyshim që shqetësimet më të mëdha të Perëndimit me Kinën 20 vitet e fundit kanë të bëjnë për shumë arsye madhore me politikën dhe marrëdhëniet ekonomike, tregtare dhe investimet mes tyre. Kjo në radhë të parë për shkak të supërvlerësimit ekonomik dhe tregtare të vendeve europiane nga Kina. Ndonëse ato i dinin problemet dhe pasojat për të cilat sot kritikojnë pa të drejtë Kinën, ato vijuan bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar sipas parimit "business as usual". Kjo në emër të leverdisë dhe tarifave të lira të blerjes së mallrave nga





Kina, të thithjes së produkteve dhe investimeve të tyre nga tregu gjigand kinez, etj. U desh lufta në Ukrainë që Perëndimi të kujtohej dhe të ndërmerre reformat e njohura tashmë, ku përfshihet dhe strategjia e re "siguria ekonomike" e lançuar nga SHBA, dhe tani në muajin Qershor Gjermania dhe BE-ja. Por, të paktën ato e kuptuan se nuk mund të ndajnë apo shkëputin dot ekonominë e tyre nga Kina; ndaj sot po flasin për "de-riskimin" ose minimizimin e rreziqeve prej Kinës; ok, vetëm se e kanë fajin vetë, dhe "mëkatet" e tyre nuk janë domosdoshmërisht "gjynahe" kineze.

Shqetësimi i dytë madhor këtu është nisma planetare "Një brez, një rrugë" që Kina lançoi 10 vite më parë, me synimet dhe arritjet e saj të njohura. Mirëpo, dhe ajo ka hasur në akuza të paqena dhe në politizime të tejskajshme në shumë vende perëndimore. Ra-

stin më të freskët e jep gazetari, ish korrespondent gjerman në Pekin, Philipp Mattheis me librin e tij të botuar më 23 Maj 2023 "Rruga e pistë e Mëndafshit (Die Dreckige Seidenstrasse) Ndër të tjera në këtë libër nënvizohet se "në autostradat që Kina ndërton, veç mallrave transportohen edhe ideologjia, dominanca dhe varësia ekonomike e atyre vendeve nga Kina" Po mirë, atëhere, çdo bërë, të mos ndërtohen këto autostrada dhe aeroporte aq të nevojshëm nga frika se siç thotë autori na rrënokan demokracitë, të cilat në shumicën e atyre vendeve as që ekziston? Pastaj, a do të ishte vërtet gjendja atje më e mirë pa këto autostrada dhe Rrugën e Mëndafshit, apo vetëm me vlerat dhe parimet e demokracisë liberale?

Ja pse, në vend që të qortojë Kinën për këtë nismë madhore, duke e etiketuar dhe si "Masterplan për sundimin e

botës" Perëndimi do të bënte mirë të ndryshonte sjelljen dhe qëndrimin ndaj Kinës dhe ndaj një numri të madh vendesh në Afrikë, Azi dhe Amerikën Latine, të cilët përse të mos e themi janë zhgënjyer prej tij. Këtë e ka pohuar kohët e fundit dhe ish ministri amerikan i Financave Larry Summers, të cilit në një vend afrikan i kishin thënë troç se "vlerat tuaja na pëlqejnë më shumë, por ama ne duam dhe rrugë e aeroporte" Mirëpo, për fat të keq, siç thuhet në një status shumë të suksesshëm në diskutet e sotme diplomatike "Kina na ndërton aeroporte, ndërsa SHBA-të na bën leksione"

Këtë nevojë komunikimi ia shprehu disa muaj më parë Presidentit Macron dhe homologu i tij i Republikës Demokratike të Kongos, Felix Tshesedeki, duke i thënë në prani të kamerave se Franca dhe BE-ja duhet të ndryshojnë sjelljen ndaj Afrikës, ta shohin atë ndryshe; të flasin me të jo si më parë, sikur ju keni gjithmonë të drejtë ndërsa ne jemi gabim"

Flitet shumë për "diplomacinë kineze të borxheve" se demokracitë që nuk, paguajnë dot borxhet, detyrohen të shesin pasuritë e tyre kombëtare".

Kritikët lenë pas dore historitë e shumta e të mëdha të suksesit të kësaj nisme, ku përfshihen vende anëtare të BE-së, Greqia, Gjermania, Italia, Hungaria. Ja pse, pavarësisht nga rreziqet dhe problemet për shlyerjen e këtyre borxheve, sipas kinezologes së njohur në Berlin, Francesca Ghiretti, "vendet afrikane kanë oreks më të madh" për mallra, kredi dhe investime kineze.

Ndaj, është më e udhës që në





vend të politizimit të tejskajshëm të gjithçkaje ” Made in China” vendet perëndimore të përmendin e të ndihmojnë konkretisht për të luftuar korrupsionin, këtë ”gangrenë sociale” që përmendet dhe në raportet e Departamentit amerikan të Shtetit dhe në Progres Raportet e Komisionit European dhe të këqia të tjera që ndeshen dhe në vende anëtare/kandidate të BE-së.

Vetëm se kujdesi në këto aspekte nuk ka të bëjë fare me frikën dhe alergjinë ndaj rreziqeve imagjinare të investimeve kineze, të cilat na rikujtojnë vitet e monizimit, kur ndihmat, kreditë dhe investimet e huaja u shpallën tradhti e lartë!

Ndaj, është pozitiv fakti që kohët e fundit, SHBA-të, BE-ja, Franca, Gjermania, Italia kanë nisur një ofensivë të gjerë diplomatike në Kinë dhe në vendet e lidhura ngushtë me të në Afrikë dhe Amerikën Latine. Më konkretisht, po bëhen përpjekje për përfundimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë MERCOSUR e cila ka 20 vite që zvarritet, ndërkohë që Kina dhe Rusia kanë hyrë me kohë atje. Dukuria më e re premtuese ishte zhvillimi më 19 – 20 Qershor në Berlin i Kon-

sultimeve qeveritare dypalëshe në nivel kryeministror. Me moton ” Të bashkëpunojmë në mënyrë konsistente.” Kjo merr rëndësi të veçantë, mbasi Kina është partneri më i madh ekonomik i Gjermanisë, me një vëllim prej 300 miliard Euro. Në vijim, mbas Berlinit, Kryeministri kinez Li Qiang shkoi për bisedime qeveritare të nivelit më të lartë në Paris, të cilat u zhvilluan me të njëjtën frymë dhe predispozicion pozitiv.

Po ashtu, BE-ja, në vend të ideologjizimit dhe demonizimit të nismës kineze ”Një brez një rrugë”, po kundërpërgjigjet me projektin e saj gjigand prej 600 miliard Euro. Megjithatë, nga Kina nuk ka patur kritika, sepse kjo është sipas saj normale, konkurrencë ekonomike.

Së fundi, problemet dhe mosmarrëveshjet midis tyre nuk zgjidhen me deklarata e kundër deklarata e qëndrime provokuese ” majë më majë” se ”kush je ti e kush jam unë”. Ca më tepër që sipas Moritz Rudolf, profesor në Universitetin Yala, Përdimi është ”i dënuar” të bashkëpunojë me Kinën të paktën në 4 drejtime jetike – mbrojtjen civile, ndryshimet klimatike, sigurimin

e drithërave dhe trysninë ndaj Rusisë që të mos përdorë armë bërthamore.

Kur Kina, pavarësisht nga vonesat, mangësitë, hezitimet dhe ndonjë qëndrim pa besueshmëri politike, ka ndërmarë hapa konkretë për një paqe të mundshme dhe në Ukrainë, siç po bën në Lindjen e Mesme dhe gjetkë. Në fakt, sot kërkohet fantazi krijuese dhe transformuese, siç thoshte Hilary Clinton. Mirëpo kjo kërkon doemos shtimin e jo pakësimin e kontakteve në të gjitha fushat, duke filluar nga mbrojtja. Sepse, nga 40 takime të ekspertëve të mbrojtjes të zhvilluara midis dy vendeve më 2013, më 2022 pati vetëm 4 të tilla!

